




WORLD BANK GROUP

BALLKANI PERËNDIMOR RAPORT I RREGULLT EKONOMIK
Nr.18 | Vjeshtë 2020

KOSOVA

NJË RIMËKËMBJE E PASIGURT | RAPORT PËR VENDIN



© 2020 International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank
1818 H Street NW
Washington DC 20433
Telephone: 202-473-1000
Internet: www.worldbank.org

Ky raport është produkt i stafit të Bankës Botërore me kontribute të jashtme. Gjetjet, interpretimet, dhe përfundimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore, ose të qeverive që ata përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë raport. Kufijtë, ngjyrat, përcaktimet ose informacionet e tjera që përmban secila prej hartave në këtë dokument nuk nënkuptojnë asnjë interpretim nga ana e Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori, ose miratimin apo pranimin e këtyre kufijve.

Të Drejtat dhe Lejet

Materiali në këtë raport është i mbrojtur nga e drejta e autorit. Meqënëse Banka Botërore nxit publikimin e punës së saj, ky raport mund të riprodhohet, i plotë ose pjesërisht, për qëllime jokomerciale me kusht që asaj t'i atribuohen të gjitha të drejtat për këtë raport. Të gjitha pyetjet lidhur me të drejtat dhe licencat, përfshirë të drejtat e riprodhimit, duhet të drejtohen në: World Bank Publications, The World Bank Group, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA; fax: 202-522-2625; e-mail: pubrights@worldbank.org.

Kosova

- Ekonomia e Kosovës pritet të tkurret me 8.8 për qind në vitin 2020; vazhdimi i COVID-19 është duke i ndikuar negativisht eksportet e shërbimeve, konsumin privat dhe investimet. Pa rritjen e remitancave dhe përgjigjen kundërciklike të politikës fiskale, tkurrja do të ishte më e thellë.
- Rimëkëmbja pritet të jetë më e ngadaltë se parashikimet e mëhershme; ndikimi i pandemisë pritet të shtrihet edhe në vitin 2021.
- Përderisa arkëtimi i të hyrave ka pësuar rënie, Qeveria është duke zgjeruar shpenzimet rrjedhëse në mënyrë kundërciklike (për të ju kundërpërgjigjur tkurrjes) përmes financimit shtesë nga borxhi publik dhe shfrytëzimi i të ardhurave nga privatizimi; por ekzekutimi i investimeve publike vazhdon të ngeçë.
- Goditja nga COVID-19 konfirmoi brishtësinë e modelit Kosovar të rritjes ekonomike të bazuar në konsum. Kjo e bën edhe më të fortë nevojën e Kosovës për rimëkëmbje të qëndrueshme që i adreson pengesat afatgjate strukturore.

Zhvillimet e fundit ekonomike

Pandemia e COVID-19 po ushtron tryzni të paprecedentë mbi aktivitetin ekonomik. Përkundër lehtësimit të masave frenuese në muajin qershor 2020, treguesit në dispozicion deri në fund të gushtit sugjerojnë se aktiviteti ekonomik vazhdon të jetë në rënie. Eksportet e shërbimeve janë më të ulëta për shkak të vizitave të kufizuara nga diaspora. Edhe konsumi privat dhe investimet kanë pësuar nga pasiguria e shkaktuar nga pandemia dhe masat për frenimin e saj. Ashpërsia e tkurrjes dëshmohet nga rënia me 9 për qind e importeve të mallrave deri në muajin korrik 2020 (importet e mallrave të ndërmjetme për prodhim ranë me 11 për qind) dhe rënia prej 13 për qind e të hyrave nga tatimet mbi konsum dhe tregti deri në muajin gusht 2020. Periudha janar–qershor 2020 (gjashtëmujori i parë) u karakterizua nga rënia e përgjithshme e qarkullimit të kompanive, me një mesatare prej gati 12 për qind, ndërkohë që shërbimet e hotelierisë dhe restoraneve përjetuan një rënie më të thellë prej 25 për qind. Edhe investimet publike pritet të bien për shkak të hapësirës së kufizuar fiskale dhe vonesave të mëtejshme në

implementim. Sidoqoftë, shtimi i remitancave dhe eksporteve të metaleve bazë, si dhe masat e miratuara fiskale, kanë shërbyer për ta zbutur ndikimin e pandemisë.

Kriza ekonomike e shkaktuar nga COVID-19 e gjeti Kosovën me treg të dobët të punës. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore në TM1 2020 ishte vetëm 38.8 për qind e popullsisë në moshë pune, e ngjashme me një vit më parë. Papunësia u ul nga 26.9 për qind e fuqisë punëtore (FP) në TM1 2019, në 25 për qind të saj në TM1 2020, si pasojë e rënies së pjesëmarrjes në FP (0.1 pp) si dhe shkallës së punësimit (0.9 pp), çka pasqyron më shumë situatën para pandemisë. Si pjesë e reagimit ndaj pandemisë, më shumë se 130,000 të punësuar morën subvencione të pagave nga qeveria. Kriza e COVID-19 vlerësohet të ketë pasur ndikim domethënës në nivelet e punësimit dhe varfërisë. Sipas Anketës së Pulsit të Biznesit (APB) në Kosovë të realizuar nga Banka Botërore, shumica e bizneseve e shkurtuan orarin e punës, dhe mënyra kryesore

për reagim ndaj krizës në anën e punësimit ishte dhënja e pushimeve të detyrueshme.

Kriza e zgjatuar e COVID-19 do ta rëndojë pozicionin fiskal të Kosovës. Deficiti i përgjithshëm buxhetor pritet të arrijë në 9.5 për qind të BPV-së, nga 2.9 për qind në vitin 2019, për shkak të rënies prej 13 për qind të të hyrave publike, shpenzimeve më të larta rrjedhëse për reagimin ndaj krizës, dhe tkurrjes domethënëse të BPV-së. Deri në fund të gushtit, qeveria kishte shpenzuar 2 për qind të BPV-së për reagimin ndaj COVID-19. Përfitimet sociale pritet të arrijnë në 8 për qind të BPV-së në vitin 2020, kurse totali i subvencioneve dhe transfereve do të rritet me të paktën 22 për qind në vitin 2020, duke reflektuar kryesisht koston e reagimeve të targetuara të politikave, përfshirë transferet në para të gatshme për firmat, të punësuarit dhe familjet. Investimet publike, nga ana tjetër, ka gjasë të ulen për shkak të hapësirës së pamjaftueshme fiskale dhe vonesave në implementim. Disa projekte të mëdha të investimeve publike që pritej të përparonin, shumë prej të cilëve janë projekte infrastrukturore të financuara nga institucione financiare ndërkombëtare (IFN), ka gjasë të vonohen sërish. Borxhi publik dhe garancionet pritet të arrijë 23.3 për qind të BPV-së për vitin 2020, dhe do të financohet nga huamarrja më e lartë e brendshme, përdorimi i të ardhurave nga privatizimi, dhe huazimet koncesionare nga IFN-të.

Kriza e gjeti sektorin financiar të Kosovës në gjendje të shëndoshë, por vala e vazhdueshme e pandemisë mund t'i intensifikojë trysnitë ndaj tij. Në muajin korrik, depozitat bankare u rritën me 12.7 për qind, me 44 për qind të kësaj rritjeje nga depozitat e amvisërive. Edhe kreditë bankare u rritën me 6.7 për qind, por pati një ngadalësim të dukshëm të kredive të lëshuara pas muajit mars. Norma mesatare efektive e interesit për kreditë e reja ra nga 6.56 për qind në periudhën janar-korrik 2019, në 6.24 për qind në vitin 2020. Mjaftueshmëria e kapitalit është ende mbi

nivelin e kërkesave rregullative. Deri në muajin korrik, kreditë jo performuese u rritën lehtësisht duke kapur nivelin prej 2.5 për qind. Me kërkesë të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), bankave komerciale iu kërkua t'i shtyjnë nga 16 marsi deri më 16 qershor pagesat e kredive për klientët që hasin vështirësi financiare, pa pasoja në historikun kreditor dhe pa penalizim. Më 8 qershor, BQK-ja nxorri një udhëzues për ristrukturimin e kredive për shkak të COVID-19, në të cilin u caktua 30 shtatori si afat për ristrukturimet e kualifikueshme. Ndërkohë që këto masa kanë shërbyer për të zbutur trysnitë mbi sektorin financiar, vala e vazhdueshme e pandemisë dhe ndikimi i saj në aktivitetin ekonomik ende paraqesin një kontekst sfidues për sektorin financiar.

Inflacioni i çmimeve të konsumit ra me uljen e kërkesës së brendshme dhe çmimeve ndërkombëtare të naftës. Ai kapi nivelin prej 2.6 për qind në vitin 2019, por deri në muajin gusht u ngadalësua në një mesatare prej 0.6 për qind. Inflacioni ra kryesisht për shkak të ngadalësimit të konsiderueshëm të inflacionit të çmimeve ushqimore, rënies së çmimeve ndërkombëtare të naftës, dhe zvogëlimit të kërkesës së brendshme. Trysnitë inflacionare u rritën pas lehtësimit të masave frenuese ndaj pandemisë në muajin qershor 2020, por morën kahje rënëse në muajt korrik dhe gusht. Inflacioni i IÇK (Indeksi i Çmimeve të Konsumit) parashihet të arrijë një mesatare prej 0.5 për qind në vitin 2020.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse do të përkeqësohet në 7.2 për qind të BPV-së në vitin 2020. Përkundër rritjes së parashikuar prej gati 10 për qind në eksportet e mallrave (13 për qind deri në korrik), eksportet totale parashikohet të bien me mbi 30 për qind pas tkurrjes dramatike të eksporteve të shërbimeve si rezultat i vizitave më të pakta të diasporës gjatë pikut të sezonit të këtyre vizitave (qershor-gusht). Importet e mallrave ranë me 9 për qind deri në muajin korrik dhe pritet të ulen

me 12 për qind deri në fund të vitit. Deri në muajin korrik, importet e mallrave të qëndrueshme (pajisjeve shtëpiake) për konsum ranë me më shumë se 16 për qind, importet e automjeteve për pasagjerë me mbi 19 për qind, kurse importet e mallrave të ndërmjetme për përpunim industrial ranë me 11.3 për qind. Deri në muajin qershor, investimet e huaja direkte (IHD) ishin rritur me 3.4 për qind falë investimeve domethënëse në energji dhe miniera në TM1. Sidoqoftë, IHD-të në patundshmëri u ulën me 18.2 për qind për gjashtëmujorin e parë. IHD-të neto u rritën me 64 për qind, nxitur kryesisht nga ulja e riatdhesimit të fitimeve të mbajtura.

Flukset hyrëse të remitancave deri në muajin korrik 2020 u rritën me 9.8 për qind, me një rritje domethënëse në remitancat që vijnë përmes kanaleve formale, të cilat kapin 47 për qind të totalit. Kjo e konfirmon sa i lartë është kontributi i remitancave në rrjetet informale të sigurisë sociale në Kosovë. Deri në qershor të vitit 2020, edhe kompensimi i të punësuarve që punojnë jashtë vendit për më pak se 12 muaj në vit ishte rritur me 8 për qind.

Parashikimi

Bazuar në të dhënat e disponueshme dhe rrjedhën e pandemisë, tkurrja e vitit 2020 pritet të arrijë në 8.8 për qind, kurse rimëkëmbja do të jetë më e gjatë. Shkalla e tkurrjes në vitin 2020 vjen si rezultat i vazhdimit të pandemisë përgjatë TM3 dhe TM4. Edhe pse masat frenuese tashmë janë dukshëm më të lehta se në TM2, kufizimet ndërkombëtare në udhëtime, masat e brendshme të nevojshme për frenimin e pandemisë, si dhe pasiguria e lartë për investime, vazhdojnë ta pengojnë aktivitetin ekonomik. Në vitin 2020, rënia e investimeve parashikohet të kontribuojë me 4.6 pikë përqindjeje (pp) në tkurrje, ndërsa konsumi i përgjithshëm, përkundër konsumit më të lartë publik, shpjegon edhe 2.6 pp të tkurrjes. Për shkak të rënies së eksporteve të shërbimeve,

eksportet neto do të heqin edhe 1.5 pp nga rritja.

Rritja parashikohet të rikthehet në 3.7 për qind në vitin 2021, dhe më pas të përshpejtohet në 4.9 për qind në vitin 2022.

Kohëzgjatja e pandemisë, ashtu si edhe madhësia e pasojave të saj ekonomike dhe sociale, janë ende shumë të pasigurta. Pas një tkurrje të theksuar në vitin 2020, rimëkëmbja modeste prej 3.7 për qind e pritur për vitin 2021 pritet të përshpejtohet nga TM3. Kontribuuesit kryesor të rritjes janë eksportet dhe konsumi, që do të nxisin ringritjen e importeve. Rimëkëmbja në vitet 2021 dhe 2022 do të varet edhe nga mënyra se si do të rikthehet rritja në BE, por dhe nga frenimi me sukses i pandemisë deri sa vaksinat të jenë përgjithësisht të qasshme. Për Kosovën, kufizimet e udhëtimeve ndërkombëtare - veçanërisht nga Gjermania dhe Zvicra - dhe reagimi i sektorit financiar ndaj një vazhdimi të zgjatur të pandemisë, janë përcaktues tjerë të rimëkëmbjes. Por, ka edhe potenciale që rritja të jetë edhe më të lartë se parashikimi, varësisht nga: sa efektive do të jetë qeveria në realizimin e plotë të planit për rimëkëmbjen ekonomike; kur dhe sa do jenë investimet nga zbatimi i marrëveshjes së kohëve të fundit për normalizimin ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për vitin 2022 supozohet të ketë përshpejtim të rritjes ekonomike, suke arritur në 4.9 për qind.

Masat e mbështetjes së rimëkëmbjes do ta zgjerojnë deficitin fiskal në vitin 2021.

Paketa për rimëkëmbjen e shpallur nga qeveria për vitet 2020–21 ka një kosto fiskale prej 530 milionë eurosh. Marrë parasysh vazhdimin e pandemisë dhe vonesat në miratimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore, shumë shpenzime nga kjo paketë mund të shtyhen edhe në vitin 2021. Ndërkohë, për të ekuilibruar vonesat në përfundimin e projekteve të investimeve publike të financuara nga IFN-të, përfshirë projektet e kontraktuara, zbatimi mund të përshpejtohet në vitin 2021.

Megjithatë, shpenzimet për transfere mbështetëse në para të gatshme pritet të jenë më të ulëta, duke i ulur shpenzimet totale të vitit 2021 me pothuajse 2 për qind. Gjithashtu, parashikohet një rritje në të hyrat publike me rreth 7 për qind dhe përmirësim i deficitit fiskal nga 9.5 në 6.7 për qind të BPV-së.

Kriza e COVID-19 pritet të ketë ndikim afatgjatë në aktivitetin ekonomik; varësisht nga kohëzgjatja e saj, ajo mund të shkaktojë mbyllje të përhershme të bizneseve dhe humbje të vendeve të punës.


Kjo do t'i kthente mbrapsht përfitimet zhvillimore të arritura me aq mund në Kosovë. Sipas APB-së, bizneset me më shumë se 5 të punësuar presin që deri në fund të vitit 2020, si rezultat i pandemisë, shitjet të kontraktohen me 17 për qind dhe vendet e punës të bien me 6 për qind.

Në periudhën afatmesme, avancimi i reformave strukturore është i nevojshëm për t'i eliminuar efektet negative

ekonomike të pandemisë dhe për t'u ndihmuar qytetarëve të bëhen më të qëndrueshëm ndaj goditjeve negative në të ardhmen. Pandemia e ka vërtetuar rëndësinë e mekanizmave që funksionojnë mirë për mbrojtjen sociale, të cilët mund t'i identifikojnë dhe mbështesin grupet e cenuara nga goditjet ekonomike duke mundësuar në të njëjtën kohë mbarëvajtjen e rezervave fiskale. Shënjestrimi më i mirë i shpenzimeve të mbrojtjes sociale ndaj më të varfërve është vendimtar si për uljen më të shpejtë të varfërisë ashtu edhe për të shërbyer si një stabilizues automatik për të parandaluar rëniet e forta të konsumit. Në mënyrë që të mbështetet rritja e lartë dhe gjithëpërfshirëse, është gjithashtu e nevojshme që Kosova të rrisë produktivitetin duke ulur barrën administrative për firmat, p.sh., duke i koordinuar më mirë inspektimet e bizneseve, duke investuar në kapital njerëzor dhe duke përmirësuar sundimin e ligjit, në mënyrë që të gjitha firmat dhe qytetarët të trajtohen me barazi.

Ekonomia e Kosovës pritet të tkurret për herë të parë.


kontributi në rritje, pikë përqindjeje



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, llogaritjet dhe projeksionet e stafit të Bankës Botërore.

Rënia e fortë e të hyrave do t'i zgjerojë deficitet fiskale.


përqindje e BPV-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Banka Botërore.


Punësimi po binte edhe para shpërthimit të COVID-19.

gjithsej punësimi



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës.


Zgjatja e pandemisë COVID-19 e ka thelluar tkurrjen në vitin 2020.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, llogaritjet dhe projeksionet e stafit të Bankës Botërore.

Inflacioni i çmimeve të konsumit është duke u lehtësuar në vitin 2020.


inflacioni i IÇK-së, përqindje



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Rritja e kreditimit u ngadalësua pas shpërthimit të COVID-19 në TM1 të gjashtëmujorit të parë.

rritja e kreditit, përqindja




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës.

KOSOVA	2017	2018	2019	2020e	2021f	2022f
Rritja reale e BPV-së (përqindje)	4.2	3.8	4.2	-8.8	3.7	4.9
<i>Përbërja (pikë përqindjeje):</i>						
Konsumi	1.5	5.4	2.3	-2.6	2.4	4.4
Investimet	1.5	2.1	1.7	-4.6	1.3	1.0
Eksportet neto	1.2	-3.8	0.2	-1.5	0.1	-0.5
Eksportet	4.0	1.0	2.8	-8.3	3.5	4.1
Importet (-)	2.8	4.8	2.5	-6.8	3.4	4.6
Inflacioni i çmimeve të konsumit (përqindje, mesatarja e periudhës)	1.5	1.1	2.7	0.5	0.6	1.2
Të ardhurat publike (përqindje e BPV-së)	26.4	26.1	26.7	25.1	25.4	26.4
Shpenzimet publike (përqindje e BPV-së)	27.6	29.0	29.5	34.5	32.1	31.1
<i>Nga të cilat:</i>						
Paga dhe shtesa (përqindje e BPV-së)	8.6	8.8	8.7	9.8	9.0	8.5
Përfitimet sociale (përqindje e BPV-së)	6.1	6.1	6.3	8.0	6.8	6.5
Shpenzimet kapitale (përqindje e BPV-së)	7.3	7.9	7.5	7.0	7.9	7.9
Bilanci fiskal (përqindje e BPV-së)	-1.2	-2.9	-2.9	-9.5	-6.7	-4.6
Bilanci fiskal primar (përqindje e BPV-së)	-0.9	-2.7	-2.5	-9.0	-6.2	-4.2
Borxhi publik (përqindje e BPV-së)	15.6	16.3	17.0	22.6	27.3	29.6
Borxhi publik dhe garancitë (përqindje e BPV-së)	16.3	16.9	17.6	23.3	27.9	30.2
<i>Nga i cili: I jashtëm (përqindje e BPV-së)</i>	6.6	6.2	5.8	8.0	10.6	11.3
Eksportet e mallrave (përqindje e BPV-së)	5.9	5.6	5.6	6.6	6.3	6.0
Importet e mallrave (përqindje e BPV-së)	44.3	46.3	45.7	44.7	43.2	43.8
Eksportet neto të shërbimeve (përqindje e BPV-së)	12.9	12.7	13.2	6.9	7.9	10.3
Bilanci tregtar (përqindje e BPV-së)	-25.5	-28.0	-26.9	-31.1	-28.9	-27.5
Flukset hyrëse të remitancave (përqindje e BPV-së)	11.1	11.3	12.0	14.1	14.1	13.9
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (përqindje e BPV-së)	-5.4	-7.6	-5.5	-7.2	-5.8	-5.3
Flukset hyrëse neto të investimeve të huaja direkte (përqindje e BPV-së)	3.3	3.4	2.8	3.7	4.6	4.6
Borxhi i jashtëm (përqindje e BPV-së)	32.6	30.3	30.4	35.4	37.2	36.7
Rritja reale e kredive private (përqindja, mesatarja e periudhës)	8.8	10.1	7.8
Kreditë jo-performuese (përqindja e kredive bruto, fundi i periudhës)	3.1	2.5	2.0
Shkalla e papunësisë (përqindja, mesatarja e periudhës)	30.5	29.5	25.7
Shkalla e papunësisë së të rinjve (përqindja, mesatarja e periudhës)	52.7	55.4	49.4
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (përqindja, mesatarja e periudhës)	42.8	40.9	40.5
BPV për kokë (në dollarë amerikanë)	3,956	4,423	4,486	4,352	4,567	4,842

Burimet: Autoritetet e vendit, vlerësimet dhe parashikimet e Bankës Botërore.

Shënim: Kontributi i mospërputhjeve statistikore ndahet në raportin prej 80 për qind dhe 20 për qind mes Konsumit dhe Investimeve përkatësisht.

Këtë raport mund ta gjeni online:
www.worldbank.org/ecc/wbrer



Monedhat

nga Faton Dermaku (Kosovë)

Faton Dermaku është një artist i ri vizual që jeton në Prishtinë, me një portofol të pasur me vepra të artit grafik abstrakt. Ai përfundoi studimet universitare dhe pasuniversitare për arte figurative në Akademinë e Arteve (Departamenti i Grafikës) të Universitetit të Prishtinës përkatësisht në vitet 2008 dhe 2010. Faton ka prezantuar punët e tija në ekspozita të ndryshme kolektive dhe ka organizuar ekspozita personale në Kosovë dhe Zvicër. Faton eksperimenton me imagjinatën e tij të historisë përmes artit modern, me një theks në kryqëzimet kulturore në imazhet historike.

Njerëzit krijojnë ide, njerëzit formojnë ëndrra dhe njerëzit krijojnë art. Për të lidhur artistët vendas me një audiencë më të gjerë, kopertina e këtij raporti dhe botimeve vijuese do të shfaqin art nga vendet e Ballkanit Perëndimor.